



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:197103

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05684545

C.nr.1396/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shaban Shala, në kontestin e paditëses V.D. nga Prishtina, të cilën me autorizim i përfaqëson av.E.K. nga Prishtina, kundër të paditurit Sh.M. nga Prishtina, për shkak të shpifjes, më datën 14.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses në këtë çështje juridike kontestimore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja V.D. nga Prishtina, të cilën me autorizim i përfaqëson av.E.K. nga Prishtina, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit Sh.M. nga Prishtina, për shkak të shpifjes.

Paditësja respektivisht i autorizuari i saj av.E.K. në shqyrtimin e dt. 14.05.2024 e tërheqë padinë në këtë çështje juridike për shkak se palët i kanë normalizuar raportet dhe se tani punojnë në kolegialitet të plotë në UPZ "Ukshin Hoti". I padituri prezent është pajtuar më tërheqjen e padisë dhe pohon faktin se raportet janë normalizuar ndërmjet tyre.

Duke marrë parasysh këtë fakt se paditësja e ka tërhequr padinë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 261 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

-Departamenti i Përgjithshëm-

C.nr.1396/19, dt.14.05.2024

Gjyqtari
Shaban Shala

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në bazë të nenit 261.4 të LPK-së.